



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2023:080562  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05608537

**PAKR.nr.203/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hashim Çollaku – kryetar i kolegjit, Vaton Durguti dhe Afërdita Bytyqi – anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtor profesional Gazmend Ramadani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit V.S., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paaautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës të Prokurorisë Themelore në Pejë PP/I.nr.39/23, të datës 24.10.2023, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.81/23, të datës 17.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPRK-së, më datë 18.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.81/23 i datës 17.10.2023, përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin V.S. për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) vit e 4 (katër) muaj**, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim

prej datës 30.03.2023 deri me 28.07.2023, ndërsa dënimi me gjobë prej **7,000.00 €** (shtatë mijë/euro) merret si i vërtetuar. Në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar mbetet i pa ndryshuar.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.81/23, të datës 17.10.2023, të akuzuarin V.S., e ka shpallur fajtor për veprat penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej pesëmijë (5000)€, si dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2000)€.

Me aplikim të dispozitave ligjore 7, 17, 38, 39 par.1 pika 1.1, 40 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3, 42, 43, 69 par.1 dhe 3, 267 par.1 dhe 366 par.1 dhe 3 të KPRK-së, si dhe nenit 360, 364, 365, 366, 453 par.1 lidhur me nenin 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së, të njëjtin e ka gjykuar:

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj, duke i llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga data 30.03.2023 deri me 28.07.2023, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe dënim unik me gjobë në shumë prej shtatëmijë (7000) €, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pasi plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Ka obliguar të pandehurin që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej njëzet (20)€ në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjithashtu ka obliguar të njëjtin që në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) € në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform 267 par. 5 si dhe nenin 366 par.3 të KPRK-së, ka konfiskuar një qese me substancë narkotike e llojit marihuanë në peshë neto prej 461.9 gram, një qese e vogël me substancë narkotike të llojit marihuanë në peshë neto prej 3.15 gram, një paketim me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë në peshë neto prej 392.48 gram, një sasi e substancës narkotike e llojit marihuanë me peshë neto prej 2.09 gram, substancën narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 424.65 gram si dhe qese najloni me mbetje për paketimin e substancës narkotike me peshë neto 26.85 gram, me peshë neto e përgjithshme  $1311.19+0.0062$  gram, si dhe një pushkë 10-she me nr. serik: H....

Ka urdhëruar Policinë e Kosovës - Njësi DHTN - DKKO në Prishtinë, që pas verifikimit të sendeve të lartcekura, të bëjë asgjësimin e tyre, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të vendimit lidhur mbi dënimin, me propozim që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore - Departamenti për Krime të Rënda - Pejë, e dt. 23.10.2023, dhe të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës shkallës së parë me shenjën PKR.nr. 81/2023, ashtu që ndaj të akuzuarit V.S. të shqiptohet dënim me i rëndë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.569/2023, të datës 07.11.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.81/23, të datës 17.10.2023, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i rëndë sesa me aktgjykimin e atakuar.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së, në të cilën nuk prezantoi asnjëra nga palët, edhe pse të njëjtit janë njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancë, por mungesën e tyre nuk e arsyetuan.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.103/2024 të datës 12.03.2024, ka aprovuar si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit V.S., av.K.K., me pretendim se ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, por gjykata e shkallës së dytë nuk e ka njoftuar për seancën e kolegjit dhe me këtë i është mohuar e drejta për t'i elaboruar pretendimet në ankesë, kurse aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.630/23 të datës 22.11.2023, e ka anuluar dhe çështjen e ka kthyer gjykatës së njëjtë në rigjykim, duke konstatuar se është shkelur dispozita e nenit 390 par.1 të KPP-së, pasi që gjykata e shkallës së dytë është dashur të njoftoj për seancën e kolegjit së bashku me mbrojtësin e tij, duke obliguar gjykatën e shkallës së dytë që në rigjykim të eliminoj shkeljen e lartpërmendur, e pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, caktoi seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së, në të cilën prezantoi mbrojtësja e të akuzuarit, av.K.K., ndërsa nuk prezantoi i akuzuari për të cilin në flete kthesë konstatohet si palë e panjohur në atë adresë, ndërsa mbrojtësja e tij në seancë ka konfirmuar se i njëjti është në dijeni për këtë seancë të kolegjit por nuk ka mund të prezantoj për shkak se gjendet jashtë vendit gjegjësisht në Zvicër tek vëllai i tij për të punuar në mënyrë që të paguaj gjobën e shqiptuar, ndërsa nuk prezantoi askush në Prokuroria e Apelit, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës. Mbrojtësja e të akuzuarit V.S., av.K.K., ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet pasi që është hera e parë që i pandehuri ka kryer veprën penale dhe qëllimi i dënimit do të arrihet edhe me dënimin e shqiptuar nën minimumin e paraparë ligjor.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës në këtë çështje së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuar në ankesë, gjeti se: **Ankesa është e bazuar.**

### **Pretendimet e prokurorisë në ankesë.**

PTH-në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, në ankesë pretendon se gjykata me rastin e trajtimit të rrethanave lehtësuese për të akuzuarin, gjatë evidentimit të tyre të njëjtat i ka mbivlerësuar në raport me matjen e dënimit të shqiptuar ndaj të njëjtit. Gjykata vetëm në mënyrë sipërfaqësore ka theksuar se, sanksioni i shqiptuar ndaj të akuzuarit është vlerësuar adekuat, i

drejtë në harmoni me peshën e veprave penale, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, me të cilat dënime mund të arrihet qëllim i dënimit i paraparë nga neni 38 i KPRK-së, e i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, rehabilitimin e tij ligjor, parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Prokuroria, sa i përket rrethanat lehtësuese të vlerësuara nga ana e gjykatës, vlerëson se kjo e fundit gabimisht i ka vlerësuar të njëjtat me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin e të pandehurit, me ç ‘rast të pandehurin V.S. e ka dënuar nën minimumin e dënimit të paraparë për veprën penale nga dispozitivi numër I (të përshkruar si në aktakuzë). Një prej kushteve që ju ka referuar gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi zbutjen nën minimum të dënimit për të pandehurin e ka marrë për bazë faktin se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë; duke renditur në këtë drejtim pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe keqardhjen e shprehur nga ana e të njëjtit lidhur me veprat penale. Në këtë drejtim gjykata ka mbivlerësuar rrethanën e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit, duke e renditur si rrethanë posaçërisht lehtësuese, ngase mendojmë se pranimi i fajësisë duhet të vlerësohet vetëm në drejtimin si rrethanë lehtësuese. Ndërsa sa i përket trajtimit të keqardhjes si rrethanë posaçërisht lehtësuese, ne si prokurori mendojmë se përveç faktit që një rrethanë e tillë është mbivlerësuar në raport me shqiptimin e dënimit, një rrethanë e tillë është edhe jo shume e besueshme, ngase këtu i akuzuari V., në të kaluarën ka kryer edhe vepra të tjera penale, për të cilat ka aktgjykime (që janë të bashkëngjitura në shkresat e lëndës), e në të cilat ka pranuar fajësinë dhe ka shprehur keqardhje, por që edhe përkundër këtij fakti i njëjti ka vazhduar të përsëris vepra penale të dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, andaj në këtë drejtim ne si prokurori çmojmë se këto rrethana që gjykata i ka marrë si rrethana posaçërisht lehtësuese, duhet trajtuar me rezervë dhe vetëm si rrethana lehtësuese të rëndomta. Sa i përket rrethanave rënduese, gjykata me rastin e vlerësimit të të njëjtave në raport me shqiptimin e dënimit, ka renditur një sërë rrethanash rënduese të cilave ju ka referuar, por që për ne mbetet e pakuptimtë që edhe përkundër këtij fakti e njëjtat ndaj të akuzuarit V.S. shqipton dënim nën minimumin e paraparë për veprat penale për të cilat akuzohet. Për me tepër dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës del të jetë kundërthënës në raport me rrethanat rënduese të renditura nga po ajo e ku përfundimisht gjykata çuditërisht ndaj të akuzuarit shqipton dënim tejet të ulët për dy veprat penale të cilat i bien në barrë sipas aktit akuzues. Gjykata nuk e ka vlerësuar si rrethanë rënduese faktin se këtu i pandehuri ka qenë me parë i dënuar, edhe përkundër faktit se prokuroria në aktakuzë ka precizuar qartë numrat e lëndëve për të cilat këtu i akuzuari Veton ka qenë i dënuar më parë nga ana e

gjykatës, e të cilat aktgjykime janë të bashkëngjitura në shkresat e lëndës. Nën këtë rrethanë ne si organ ndjekës mendojmë se gjykata në këtë drejtim gabimisht nuk e vlerëson si rrethanë rënduese faktin se i pandehuri ka qenë më parë i dënuar. Bazuar në këto arsye kërkon nga gjykata që të vendosë në favor të ankesës.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë me ankesë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi, konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së, dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara sipas dispozitës së nenit 384 të KPPRK-së, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e detyrueshëm të tij apo ndonjë shkelje të ligjit penal në dëm të pandehurit.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, meqenëse konform dispozitës së nenit 383 par. 2 të KPP-së, as që mund të kontestohet aktgjykimi i ankimuar përkitazi me këtë bazë ankimore, ngase i akuzuari V.S. e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, dhe gjykata e kishte aprovuar pranimin e fajësisë, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit të shtetit për një dënim me të ashpër janë të bazuara.

Gjykata e Apelit vlerëson se, pretendimet e prokurorisë lidhur me vendimin mbi dënim janë të bazuara, kjo për faktin se rrethanat lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë siç janë: pendimin e të pandehurit lidhur me veprat penale, faktin se ka dy fëmijë të mitur dhe njëri nga ta është foshnje, është mbajtës i vetëm i familjes, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese bazuar në nenin 70 par 3 pika 3.10 dhe 3.11 të KPPRK-së, pranimin e fajësisë dhe keqardhjen e shfaqur, kurse në anën tjetër si rrethana rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit të kryer me dashje direkte dhe paramendim, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, që është shëndeti i të rinjve, gjithashtu në bazë të të dhënave në Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) nuk evidentohet se ka qenë i dënuar, e rrjedhimisht

i njëjti mund të ketë qenë i dënuar, mirëpo është rehabilituar, rrethanat e tilla nuk justifikojnë një dënim të tillë të shqiptuar në aktgjykimin e ankimuar nga gjykata e shkallës së parë ngase, dhe sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj Gjykate, ashtu si me të drejtë thekson prokuroria në ankesë, këto rrethana sidomos ato veçanërisht lehtësuese, edhe pse pranimi i fajësisë në aplikim të nenit 70 par.3 të KPP-së nga gjykata e shkallës së parë, këtë rrethanë nuk e kategorizon si rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj sipas bindjes së këtij kolegji janë mbivlerësuar e që ka rezultuar që të caktohet një dënim më të butë të përcaktuar për veprat penale. Në aktgjykimin e ankimuar nuk është bërë një peshim objektiv i të gjitha rrethanave të cilat ndikojnë në matjen e dënimit duke i mbi peshuar kështu vetëm rrethanat lehtësuese në përcaktimin e dënimit që ka rezultuar në një vendim me dënimin që nuk i përgjigjet arritjes së qëllimit të dënimit.

Gjykata e Apelit duke i rivlerësuar të gjitha rrethanat e konstatuara nga gjykata e shkallës së parë për matjen e dënimit nga gjykata e shkallës së parë, e duke marrë për bazë sjelljen e mëparshme të kryesit konform nenit 69 par.3 pika 3.5 të KPK-së, ashtu si thekson edhe prokuroria në ankesë se i akuzuari edhe më parë ka kryer veprat tjera penale, e që ky fakt konstatohet si në procesverbal të PP/I.nr.39/23 dt.21.08.23, *(për veprat penale të armëve, për vepër penale të lëndim, kërcënim, falsifikim i dokumenteve, vjedhje pylli)*, si dhe faktin e sasisë së narkotikut në këtë rast, *(1311.19+0.0062 gram)* e në aplikim të dispozitës së nenit 71 par.1 nënpar.1.3 dhe 72 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale e të akuzuarit, rrethanat e kryerjes së këtyre veprave penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, që është shëndeti i të rinjve, me bindjes se me këtë dënim do të ndikoj në parandalimin e kryesit për kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, e me të cilën dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga arsyet e lartcekura, e në bazë të nenit 403 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PAKR.nr.203/2024, më datë 18.04.2024**

**Bashkëpunëtor profesional**

**Anëtarët e kolegjit**

**Kryetari i kolegjit**

---

**Gazmend Ramadani**

---

**Vaton Durguti**

---

**Hashim Çollaku**

---

**Afërdita Bytyqi**